



## **Raport Përmbledhës** **Takimi i Grupit të Punës për Çështjet Sociale dhe Investimet #10**

5 Tetor 2017 – Hotel Fieri

**Nga lehtësues të CAO-s**  
Rasim Gjoka, Adi Gavriła, Merita Bala

---

Ky raport përmbledh diskutimet dhe çështjet e rëna dakord në takimin e Grupit të Punës për Çështjet Sociale dhe Investimet (10), ku morën pjesë anëtarët e përhershëm të grupit të punës (anëtarë të komunitetit nga Patos-Marinza dhe përfaqësues nga kompania Bankers Petroleum Albania Ltd. (BPAL). Në këtë takim mori pjesë dhe një përfaqësuese nga zyra e CAO-s në Washington D.C, Anne-Claire Olivera, Analiste Kërkimesh, dhe tri ndërmjetëse vëzhguese.

Raporti është përgatitur nga lehtësuesit e CAO-s. Pjesëmarrësve të takimit iu kërkua ta rishikonin këtë raport përmbledhës dhe të bënin sugjerime, korrigjime ose reflektive.

### **PROGRAMI I TAKIMIT**

1. Diskutim dhe dakortësi për listën e çështjeve sociale dhe të investimeve
2. Reflektim nga kompania për çështjet e ngritura në takimin e fundit (mbështetja për fëmijët, kontrolli mjekësor)
3. Hapat e mëtejshëm

### **1. Diskutim dhe dakortësi për listën e çështjeve sociale dhe të investimeve**

Qëllimi kryesor i takimit ishte të diskutohej lista e çështjeve sociale dhe të investimeve dhe të arrihej dakortësi për statusin e secilës çështjeje dhe hapat e mëtejshëm, pra se cila çështje do të konsiderohet e mbyllur, cila çështje do të kalojë në monitorim dhe si do të bëhet monitorimi, dhe cila çështje duhet të vazhdojë të jetë pjesë e diskutimeve/negocimeve.

Diskutimi për secilën çështje u drejtua nga tri pyetje:

- A mund të arrihet një marrëveshje për hapat e mëtejshëm?
- Nëse ka një marrëveshje, si do të zbatohet, nga kush dhe kur?
- Si do të monitorohet zbatimi i marrëveshjes, dhe cili do të jetë roli i CAO-s?

Përfundimet e diskutimit për secilën çështje janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme të listës së çështjeve:

Kategoria	Nr	Veprimet/Nevojat	Statusi i Veprimit/Diskutimet (para takimit të datës 5 tetor 2017)	Diskutimet në takimin e datës 5 Tetor	Marrëveshjet për hapat e mëtejshëm
Burimet Njerëzore	1.	Praktika mësimore për studentët lokalë që studiojnë në fushën e naftës dhe gazit apo në fusha të ngjashme, dhe mundësisht t'i punësojë ata më pas.	BPAL do të koordinojë me Fakultetin e Inxhinierisë dhe Minierave rreth praktikave mësimore. BPAL është e hapur për marrëveshje të tilla dhe me fakultete të tjera. Kjo do të organizohet çdo vit.	BPAL informoi se ata kanë një program të praktikës mësimore me Fakultetin e Inxhinierisë dhe Minierave dhe Fakulteti dërgon studentët më të mirë dhe gjithashtu studentët nga zona. Për mundësinë e punësimit të këtyre studentëve, BPAL përmendi se që nga viti 2015, kompania nuk ka marrë në punë punonjës të tjerë për shkak të faktorëve si rënia e çmimit të naftës, ndryshimi i pronësisë së kompanisë. BPAL prezantoi statistika për numrin e largimeve nga puna, p.sh. nënkontraktorët e Simons kishin pushuar rreth 70-75% të të punësuarve. Komuniteti shprehu interes për punësimin e studentëve nga zona. Kompania u përgjigj se punësimi bëhet bazuar në nevojat e BPAL dhe theksoi se ata punësojnë njerëz në bazë të kualifikimeve të tyre.	1. Kompania do të nxjerrë njoftimin për programin e praktikës në faqen e internetit të kompanisë dhe në median lokale. 2. CAO do të kontrollojë nxjerrjen e njoftimit në faqen e BPAL dhe në median lokale (të paktën në verën e ardhshme).
	2.	Rishikimi i kontratave me nën-kontraktorët (për çështjen e punësimit të banorëve).	Bankers ka përfshirë një dispozitë në kontratat me nënkontraktorët ku konstatohet "nën kushte të barabarta, banorët vendas do të kenë përparësi në punësim". Bankers do të ndajë rregullisht informacion dhe statistika me komunitetin në lidhje me punësimin nga BPAL të banorëve vendas.	Çështja e punësimit të banorëve vazhdon të ngrihet nga anëtarët e komunitetit në diskutimet me kompaninë. Kompania ritheksoi se i kanë rishikuar kontratat me nënkontraktorët me qëllim rritjen e punësimit të banorëve; megjithatë, ata nuk mund t'i detyrojnë nënkontraktorët. Ata gjithashtu përmendën situatën aktuale të vështirë në lidhje me mundësitë e punësimit. Kompania është e hapur për ndarjen e informacionit lidhur me punësimin. Një kërkesë e tillë mund t'i drejtohet Qendrës së Informacionit të kompanisë.	1. Kompania do të paraqesë statistika në lidhje me punësimin e banorëve sipas fshatrave dhe informacion për vendet e lira (si për ata të punësuar nga BPAL dhe kontraktorët). 2. Çdo tremujor raporti për statistikat e punësimit do të prezantohet në Tryezën e organizuar nga Grupi i Dialogut. 3. CAO do të ftohet të marrë pjesë në dy takimet e ardhshme.
	3.	Shqyrtimi i mundësive për punësimin e teknikëve të naftës dhe gazit, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm.	BPAL është e angazhuar për të mbështetur çdo iniciativë nga autoritetet arsimore të shtetit në lidhje me krijimin e një programi trajnimi për teknikët vendas të naftës dhe gazit. Priten dhe kontribute nga komuniteti. Rregullisht	Numri i teknikëve të tillë është shumë i kufizuar dhe sipas kompanisë, BPAL ka nevojë për persona me diplomë universitare, me aftësi të përparuar.	1. Anëtarët e komunitetit do të identifikojnë teknikët në komunitet – dhe do të sjellin CV-të e tyre në Tryezën e Dialogut. 2. Përfaqësuesit e kompanisë në Tryezë do t'ia paraqesin CV-të Departamentit të Burimeve Njerëzore. 2. Mjeti i monitorimit: Tryeza e Dialogut 3. CAO do të ftohet të marrë pjesë në 1-2 takime.
	4.	Përdorimi i medias sociale për të shpallur vendet e lira pune.	Dy takime janë fokusuar në dhënien e informacionit nga BPAL për politikën e punësimit dhe praktikën e marrjes në punë. Veprime të mundshme që mund të ndërmerren: - BPAL të përdorë mjete të ndryshme (zyrën rajonale të punësimit, website-in, median sociale) për të shpallur mundësitë e punësimit. - BPAL të informojë në lidhje me mjetet/kanalet që përdor për të shpallur vendet vakante.	BPAL përmendi praktikën e ndjekur në shpalljen e vendeve të lira të punës: - Website-it të kompanisë; - Qendra e Informimit në Marinëz; - Media lokale;  Në lidhje me përdorimin e LinkedIn, kompania u shpreh se ata nuk e përdorin këtë faqe interneti për të shpallur vendet e lira të punës.	1. Kompania do të vazhdojë të shpallë vendet e lira të punës përmes: - Website-it të kompanisë; - Qendrës së Informimit në Marinëz; - Median Lokale.  2. CAO do të ftohet të marrë pjesë në 1-2 takime, ku kompania të japë informacion në lidhje me punësimin.

Programi i Investimev e në Komunitet	5.	BPAL ofron të prezantojë rezultatet e anketës për prioritetet e investimeve. Organizimi i takimeve për të diskutuar gjetjet e anketimit me tri grupe të ndryshme: burra, gra, dhe të rinj. Grupet nuk duhet të jenë më shumë se 15 persona.	Në total janë organizuar 15 takime me burra, gra dhe të rinj të fshatrave Belinë, Marinëz, Zharrëz, Sheqishte dhe Kallm i Madh, ku janë prezantuar anketat e bëra për secilin fshat. Përfunduar Tetor-Nëntor 2015.	Kompania informoi se ata përdorin mekanizmin e Monitorimit dhe Vlerësimit të investimeve. Anketimet realizohen çdo dy vjet.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kompania do të kryejë një anketim në muajt Janar-Shkurt 2018.</li> <li>2. Anëtarët e komunitetit do të punojnë me kompaninë për të përgatitur pyetësorin si pjesë e anketimit çdo dy vjet dhe të organizojë fokus-grupe për prezantimin e gjetjeve të anketimit.</li> <li>3. CAO do të ftohet në 1-2 takime para muajit Qershor 2018.</li> </ol>
	6.	Ndarja e zonës industriale nga zona e banuar me një resht me pemë, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit	Palët ranë dakord që BPAL të mbjellë 1000 rrënjë të pemë paulania deri në Mars 2016. Është rënë dakord nga pjesëmarrësit për hartën e mbjelljes së pemëve. Pemët po mbillen në tokë publike, në anë të vendeve ku operon BPAL. Përfunduar Dhjetor 2015 – Shkurt/Mars 2016 Grup monitorues i përbashkët për të parë numrin e pemëve të mbjella, të pemëve që mungojnë, etj.	Kompani informoi se do të mbjellin 10 hektarë me pemë (në zonën midis fshatit Belinë dhe shtratit të lumit Seman, ku ka dhe puse që operohen nga kompania). Anëtarët e komunitetit nga Mbrostari kërkuan që të mbjellja e pemëve të bëhet dhe në vendet ku është grumbulluar dheu i ndotur. Sipas kompanisë, këto grumbullime ishin të hershme, jo nga kompania, dhe se mbeturinat duheshin grumbulluar në një vend.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nëntor-Dhjetor 2017: BPAL do të mbjellë 10 hektarë me pemë (ndërmjet fshatit Belinë dhe infrastrukturës së tyre – me pemë eukalipti).</li> <li>2. Monitorimi: Informacioni i prezantuar në Tryezën e Dialogut dhe vizita në terren.</li> <li>3. CAO do të ndjekë 1-2 takime të Tryezës.</li> </ol>
	7.	Të diskutohet dhe të bihet dakord për strategji për të zgjidhur çështjen e ujit në Marinëz: Të arrihet marrëveshje për hapat konkretë që do të ndërmarrë BPAL për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjes së ujit përmes programit të investimeve në komunitet, dhe për rolin që mund të luajnë anëtarët e komunitetit në këtë përpjekje. BPAL të kontrakttojë një kompani hidro-teknike për të bërë një vlerësim të sistemit të ujësjellësit, dhe do të identifikojë mënyra për të mbështetur dhe	Në vijim të Memorandimit të Mirëkuptimi, BPAL dhe bashkia Roskovec ranë dakord për të punuar së bashku për të arritur objektivat lidhur me studimin e fizibilitetit për Projektin e furnizimit me ujë të Marinzes. BAPL ofron fonde për studimin dhe pjesën inxhinierike të projektit ndërsa bashkia mbikëqyr aktivitetet dhe siguron lejet përkatëse. Palët kane renë dakord të përfshijnë një ekspert në hartimin dhe zhvillimin e projektit në fazën studimore. Studimi i para-fizibilitetit ka përfunduar, kontrata me palën e trete është firmosur dhe financimi është siguruar. Koha e zbatimit: Tetor 2015-Nëntor 2016.	Kjo çështje është e zgjidhur sipas kompanisë dhe se ata i kanë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre të përcaktuara në Memorandumin e Mirëkuptimit me Bashkinë, madje duke i tejkaluar ato.  Projekti është përfunduar në Dhjetor 2016.	Nuk nevojiten veprime të mëtejshme.

		zgjdhur çështjen e furnizimit të komunitetit me ujë.			
	8.	Të sigurohet ngrohje për shtatë shkolla në zonën ku operon BPAL.	Pas negociemeve midis anëtarëve të komunitetit dhe kompanisë, BPAL siguroi mbështetje për ngrohje për shtatë shkolla për 2 muaj. Përfunduar: Shkurt 2016.	Anëtarët e komunitetit kërkuan nëse mund t'i drejtohen kompanisë në rast të situatave emergjente në lidhje me ngrohjen e shkollave, si ajo në shkurt 2016. Kompania u përgjigj se ata kanë ofruar mbështetje në rastet kur iu është drejtuar një kërkesë e ngjashme për ndihmë. Kompania u sugjeroi anëtarëve të komunitetit që t'i bëjnë një kërkesë Departamentit të Marrëdhënieve me Komunitetin për përdorimin e mbetjeve të drurit, të cilat mund të përdoren për ngrohjen e shkollave.	1. Kompania mund të sigurojë mbetje drusore për shkollat përmes Departamentit të Marrëdhënieve me Komunitetin duke filluar që në Tetor 2017, me dorëzimin e një kërkesë. 2. Monitorimi: Tryeza e Dialogut, Zyra e Marrëdhënieve me Komunitetin në Fier. 3. CAO do të monitorojë përmes (1) informimit nga anëtarët e komunitetit në lidhje me adresimin e shqetësimit/emergjencës DHE (2) duke u informuar nga kompania se si është adresuar shqetësimi.
Burimet Njerëzore	9.	Organizimi i kurseve profesionale për të rinjtë nga komuniteti ku operon kompania për të rritur aftësitë e tyre në fushën e naftës.	BPAL ka prezantuar informacion për kurset profesionale të ofruar nga kompania gjatë dy viteve të fundit, si kurset e gjuhës, dhe programe të tjerë, duke prezantuar të dhënat për numrin e përfituesve. Po zbatohet një proces për vlerësimin e nevojave, i cili nevojitet para se të ndërmerren angazhime.	Kompania u shpreh se nuk ka shumë përvojë të mirë me kurset profesionale (kurset nuk iu janë përgjigjur nevojave të tregut). Anëtarët e komunitetit i vlerësuan pozitivisht kurset e gjuhës angleze. Kompania informoi pjesëmarrësit se, bazuar dhe në sugjerimet e anëtarëve të tjerë të komunitetit, ata e propozuan kursin e anglishtes që të jetë pjesë e programit të investimeve për vitin 2018, por Albpetrol-i nuk e ka miratuar këtë plan. U kërkua që kompania ta konsultojë programin e investimeve me komunitetin para se t'ua paraqesë për miratim institucioneve përkatëse.	1. Programi i Investimeve në Komunitet që do t'i paraqitet Albpetrol-it do të konsultohet me anëtarët e komunitetit përmes Tryezës së Dialogut. 2. Procesi i konsultimit fillon në 1 korrik dhe axhenda përgatitet që në muajin Prill dhe Maj 2018. 3. Korrik-Gusht: procesi i konsultimit për buxhetin e investimeve që do t'i paraqitet Albpetrol-it. 3. CAO do të ftohet në takimin e radhës.
Programi i Investimeve në Komunitet	10.	Diskutim i propozimeve konkrete për sistemin e ujit të pijshëm në Kallm.	Nevojitet një proces i përbashkët për analizimin e situatës për të vlerësuar gjendjen aktuale të sistemit para se të bëhen ndërhyrje të mundshme.	Projekti i ujit për Kallmin do të mbështetet nga projekti TAP.	Kjo çështje është e mbyllur.
	11.	Të eksplorohehen mundësi se si BPAL mund të krijojë më shumë biznese sociale.	BPAL do të krijojë një proces për mbështetjen e bizneseve sociale si: krijimi i një call center në partneritet me pushtetin vendor; ose krijimi i një strukture permanente (OJQ, ose strukturë tjetër) për të siguruar grante të vogla për biznesin lokal. BPA mund ta mbështesë procesin.	Kompania informoi se ata nuk mbështesin biznese sociale. Megjithatë do të vazhdojnë të mbështesin programin e bujqësisë dhe të sipërmarrjeve të vogla e të mesme (SME) përmes thirrjes për paraqitje të projekt-propozimeve.	1. Kompania do të vazhdojë të mbështesë Programin e Bujqësisë dhe të SME-ve dhe do të ndajë informacionin me anëtarët e komunitetit. Anëtarët e komunitetit do ta ndajnë këtë informacion në komunitetet përkatëse. 2. Ndarja e informacionit për Programin do të behët në takimet e Tryezës së Dialogut. 3. Monitorimi: CAO do të ndjekë një takim ku do të prezantohet ky informacion, para muajit qershor 2018.
	12.	BPAL ofron të krijojë grupe prej 3-4 personash të kualifikuar nga secili komunitet, dhe t'i mbështesë financiarisht për të hartuar projekte cilësore që mund t'i drejtohen qeverisë	BPAL do të mbështesë krijimin e një programi permanent të komunitetit për të identifikuar mundësi financuese dhe shkrimin e projekt-propozimeve. Për këtë do të nevojitet dhe mendimi i pushtetit vendor. BPAL mund të ofrojë mbështetje. Projekt-propozimet mund të paraqiten nga pushteti vendor, OJQ lokale,	Nuk është një ide funksionale, kështu që nuk ia vlen të diskutohet më tej. Megjithatë kompania do të vazhdojë të zbatojë programin e investimeve në komunitet.	1. BPAL do të vazhdojë Programin e Investimeve në Komunitet (bujqësi, mbështetje për biznesin dhe përmirësimin e infrastrukturës). 2. Kompania do të marrë propozime nga anëtarët e komunitetit dhe do t'ia adresojë pushtetit vendor. 3. Monitorimi: CAO do të ndjekë një ose dy takime para qershorit 2018.

		për financim – në përputhje me detyrimin e shtetit për financime për zonat e prekura.	etj.		
Transparenca	13.	CAO të lehtësojë organizimin e një takimi të EITI-it (Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse) në Marinëz, me pjesëmarrje më të gjerë të anëtarëve të komunitetit në këto takime.	Në Maj 2015 u mbajt një takim në Fier me grupin e punës të Çështjeve Sociale dhe të Investimeve, ku u prezantua informacion rreth EITI-it dhe taksave të paguara nga BPAL. Është kërkuar që një takimi i tillë të organizohet në Marinëz në vitin 2016.	E përfunduar. Një takim për transparencën u organizua nga CAO në Marinëz, me 2 nëntor 2016 (EITI-BPAL-anëtarë të komunitetit nga Marinza).	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. (a) Anëtarët e komunitetit mund t'i drejtohen kompanisë për t'u ftuar në takimin e EITI-it; (b) Palët mund të ftojnë EITI-in të prezantojë informacion për EITI-in dhe taksat e paguara nga BPAL.</li> <li>2. Vendimet do të merren në takimet e Tryezës së Dialogut.</li> <li>3. CAO do të ndjekë një ose dy takime të Tryezës së Dialogut.</li> </ol>

Palët dolën me përfundimin se, me marrëveshjet e përfshira në kolonën e fundit, u jepet zgjidhje çështjeve sociale dhe të investimeve duke përbushur qëllimet e tyre. Ata ranë dakord se çështjet sociale dhe të investimeve janë në fazën e monitorimit dhe ranë dakord për angazhimin e komunitetit dhe kompanisë, si dhe rolin e CAO-s, në fazën e monitorimit.

Palët diskutuan gjithashtu dhe ranë dakord për një platformë të angazhimit të përbashkët në lidhje me adresimin e çështjeve që mund të ngrihen në të ardhmen.

## **2. Reflektim nga kompania për çështjet e ngritura në takimin e fundit (mbështetja për fëmijët, kontrolli mjekësor)**

Kjo pikë e axhendës nuk u diskutua për shkak të kohës së kufizuar. Diskutimi i listës së çështjeve dhe hapave të mëtejshëm për secilën çështje kërkoi më shumë kohë seç ishte planifikuar.

## **3. Hapat e mëtejshëm**

Përveç angazhimeve për secilën çështje, pjesëmarrësit diskutuan dhe për vazhdimësinë e procesit të dialogut komunitet-kompani, aktualisht të lehtësuar nga CAO, si dhe për përfundimin e përfshirjes së CAO-s.

Angazhime:

- CAO do të përgatisë një draft-Udhëzues për Rregullat e Tryezës së Dialogut që do të përdoren nga komuniteti dhe kompania në të ardhmen;
- Draft-Udhëzuesi do të diskutohet në takimin e radhës së grupit të çështjeve Sociale dhe Investimeve;
- Takimi i radhës i grupit për Çështjet Sociale dhe Investimet do të mbahet në nëntor 2017;
- CAO do t'i përmbledhë të gjithë hapat e mëtejshëm të rënë dakord në një dokument që do të publikohet në faqen e internetit të CAO-s. Dokumenti do të diskutohet paraprakisht me palët.